



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 126, Datë 30 / 11 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 95, datë 03.08.2017, të paraqitur nga subjekti ankues F.K¹, kundër Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës”.

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në qytetin e Beratit, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në qytetin e Beratit. Një nga këto ankesa është në emër të shtetasës F.K.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga F.K, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

F.K në formularin e ankesës deklaroi se: *“Ka 3 vjet që ka aplikuar për bonus strehimi dhe nuk ka marrë ende përgjigje nga bashkia. F.K informon se kanë përfituar familje të tjera që nuk e meritojnë dhe ajo që ka 2 fëmijë fle në ambient të hapur”*. Ankuesja kërkon nga Bashkia Berat që të përfitojë strehim.

Raca, është shkak për të cilin ligji nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky

¹ Ankuesja i përket komunitetit rom.

ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën Nr. 788/1 prot, datë 23.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Berat, lidhur me ankesën e bërë nga F.K, për pajisjen me strehim.

Me shkresën nr. 3683/1 Prot, datë 06.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Berat, informon se: “*Bashkia Berat aktualisht është në zbatim të dy programeve të Strehimit Social, programi i bonusit të qirasë dhe programi i ndërtimit të banesave me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave. Programi i kredisë së zbutur nuk është në zbatim që nga vitit 2013 edhe pse është një nga programet që ka më shumë kërkesa nga familjet e pastreha sidomos nga familjet e reja. F.K nuk ka aplikuar pranë Bashkisë Berat si i pastrehë, në mënyrë që të trajtohej nga ana e bashkisë, me një nga programet që janë duke u zbatuar*”.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

Programet sociale për strehimin e familjeve në zonat urbane rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit të Banorëve të Zonave Urbane” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në nenin 1, pika 2, të këtij ligji, ku citohet se: “*Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë*”, Bashkia Berat, ka për detyrë të trajtojë çështjet e strehimit social.

Ligji Nr.9232/2004, “*Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane*”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 574, datë 29.08.2012 “*Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore*”, kërkon detyrimisht aplikimin dhe plotësimin e dosjes përkatëse për të përfutur nga programet e strehimit.

Bazuar në përgjigjen shkresore të dërguar nga Bashkia Berat², nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e Bashkisë Berat, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk ka aplikuar për strehim

² Nr. 3683/1 Prot, datë 06.09.2017

pranë njësisë vendore në të cilën figuron i regjistruar, për të përfituar nga programet sociale të strehimit, duke plotësuar fillimisht dokumentacionin përkatës të strehimit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe c/, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, ndaj F.K, nga ana e Bashkisë Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të përfitojë nga Programet Sociale të Strehimit që disponon Bashkia Berat, të paraqitet pranë kësaj njësie vendore, për të plotësuar fillimisht formularin tip të strehimit, dhe më pas për të depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI